



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

Nr. 6320 prot.

Himarë, më 03.09 2026

**NJOFTIM PËR DËGJESË PUBLIKE
BANORËVE TË KOMUNITETIT TË BASHKISË HIMARË**

Në zbatim të ligjit nr. 139/ 2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” si dhe mbështetur në rregulloren e Këshillit Bashkiak Himarë “Për konsultimet publike”, ligjin nr.107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”(i përditësuar), VKM-në nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”(i përditësuar):

Ju njoftojmë se do të zhvillohet dëgjesa publike, pasi ka përfunduar procesi i dorëzimit të kërkesave të qytetarëve në kuadër të:

**“RISHIKIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR TË BASHKISË
HIMARË, MIRATUAR ME VENDIM TË K.K.T –SË, NR.2 DATË 16.10.2017, I
RISHIKUAR ME VENDIM NR.5 DATË 10.06.2020, VENDIM NR.5 TË K.K.T –SË
DATË 15.04.2021, VENDIM NR.2 TË K.K.T-SË, NR.2 DATË 25.04.2023”**

Ftojme të gjithë grupet e interesit duke përfshirë por pa përjashtuar, qytetarët, bizneset, grupet e marginalizuara, të rinj/të reja dhe pjestarë të shoqërisë civile, të bëhen pjesë e dëgjesës për një proces transparent dhe gjithëpërfshirës.

Takimet do të zhvillohen sipas kalendarit të mëposhtëm:

14 Shtator 2026 (e hënë)

10:00 — Lukovë — Nivicë — Qendra e fshatit
12:00 — Lukovë — Shën Vasil — Qendra e fshatit
14:00 — Lukovë — Sasaj — Qendra e fshatit
17:00 — Lukovë — Lukovë — Qendra e fshatit

15 Shtator 2026 (e martë)

09:00 — Lukovë — Piqerras — Qendra e fshatit
11:00 — Lukovë — Qazim Pali — Qendra e fshatit
13:00 — Lukovë — Shkallë Borsh — Shkallë
17:00 — Lukovë — Borsh — Qendra e fshatit

16 Shtator 2026 (e mërkurë)

09:00 — Horë-Vranisht — Bolenë — Qendra e fshatit
11:00 — Horë-Vranisht — Tërbac — Qendra e fshatit
13:00 — Horë-Vranisht — Vranisht — Qendra e fshatit

17 Shtator 2026 (e enjte)

15:00 — Horë-Vranisht — Kallarat — Qendra e fshatit

17:00 — Horë-Vranisht — Kuç — Qendra e fshatit

18 Shtator 2026 (e premte)

10:00 — Lukovë — Fterrë — Qendra e fshatit

14:00 — Himarë — Himarë (Qendër) — Salla “Neço Muko”

Këto takime kanë si qëllim kryesor bashkëpunimin dhe mbledhjen e rekomandimeve dhe mendimeve tuaja mbi këtë çështje e cila ka prioritet për t’u përfunduar si proces.

Gjithashtu mirëpresim rekomandime, propozime dhe sugjerime konkrete të cilat mund të dërgohen në adresat e mëposhtme të “e-mail”-it:

- Adresa zyrtare e bashkisë Himarë: info@himara.gov.al

Kjo dëgjese do të zhvillohet në bashkëpunim me Bashkinë Himarë dhe me anëtarë/përfaqësues të Këshillit Bashkiak Himarë.

Jeni të lutur të merrni pjesë, pasi pjesëmarrja juaj është e rëndësishme.

KRYETARI

Vangjel Tavo

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSKRYETARI

Erifili Berberi

